



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i draftkalendarit të punës së komisionit për periudhën 25 nëntor – 20 dhjetor 2019.
2. Miratimi i draftkalendarit të komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020.”
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, (STCW) 1978”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Ediola Braha, Nikolin Staka, Artemis Malo dhe Arlind Çaçani

Mungojnë:

Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Alban Zeneli dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës

Thimjo Plaku - Drejtor

Bledar Karoli - Përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës

HAPET MBLEDHJA

(Probleme me sistemin e incizimit)

Artan Shkreli – Mirë se ju gjej!

Faleminderit për pritjen!

Ne jemi këtu për të prezantuar projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët”. Te termi “detarët” përfshihet në përgjithësi i gjithë personeli i njerëzve, të cilët lëvizin me anije të ndryshme, qoftë të flotës tregtare, qoftë anije turistike, kruizera e të tjera.

Këtu kemi të bëjmë me një amendim, jo me krijim e një akti të ri, të konventës ndërkombëtare ku ne kemi aderuar. Vetë konventa është një material shumë voluminoz me rreth 250-300 faqe, një kod dhe është shumë e rëndësishme qëndrimi në këtë organizëm.

Kjo ka bërë të mundur që 99,2 e tonazhit botëror të flotave që lëvizin, sidomos të tonazhit të shkëmbimit të mallrave, të aderojnë në këtë organizëm. Do të thotë, sa herë ata azhurnojnë të dhënat e tyre, po aq herë ne duhet t’i përmbledhim në një paketë dhe të bëjmë azhurnimin tonë. Në rastin konkret, azhurnimi i kësaj konvente bëhet për shkak të disa normativave të reja që janë krijuar si rezultat i avancimit të teknologjisë, i përshtatjeve sidomos me klimën e re, që ka të bëjë me ngrohjen globale, por edhe të gjërave që kanë të bëjnë me modernizimin e flotës në përgjithësi.

Unë nuk dua të ndalem në elementet teknike, por gjërat kryesore të kësaj janë:

Përmirësimi i masave për të parandaluar taktikat mashtruese që lidhen me dhënien e certifikatave të kompetencës.

Kjo ka të bëjë, qoftë me detarët tanë kundrejt palëve të treta dhe palëve ndërkombëtare, qoftë edhe me detarët e huaj, të cilët hyjnë në ujërat tona territoriale apo në Shqipëri si tranzit apo edhe për të punuar pranë flotave tona, të cilët duhet të certifikohen dhe të njihen kualifikimet e tyre mbi bazën e kësaj konvente ndërkombëtare ku ne aderojmë.

Rishikimi i kërkesave për orët e punës dhe të pushimit dhe kërkesat e reja për parandalimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin, si dhe standardet e përditësuara në lidhje me standardet e përshtatshmërisë mjekësore për detarët.

Edhe këtu kemi disa ndryshime në kodin ndërkombëtar. Në njëfarë mënyre ne ratifikojmë edhe orët e punës, të cilëve u kalkulohen në një mënyrë të caktuar, sepse ne e dimë që ndonjëherë detarët kalojnë 24 orë në det dhe ndryshe është ora e punës aktive dhe ndryshe llogariten orët e punës ku ata janë në pasivitet gjatë kohës që presin turnin.

Kërkesat e reja të certifikimit për detarët.

Këtu jemi te pjesa që bëjmë azhurnimin me kërkesat e reja që ka konventa ndërkombëtare, që neve nuk na sjellin as rritje në buxhet dhe as kosto shtesë në këtë rast.

Kërkesat e reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne, siç janë kërkesat elektronike dhe sistemet e informacionit (ECDIS).

Kërkesat e reja për trajnimin dhe paralajmërimin për ndotjen ndaj mjedisit detar dhe trajnimin e drejtuesve e punës në grup. Këto janë disa kërkesa që janë shtrënguar kohët e fundit nga konferenca. Sidomos ndotja e detit është bërë një problem shumë i madh dhe ka edhe sanksione, jo vetëm për ndotjen e detit tonë nga të huajt, por edhe ujërat ndërkombëtare sidomos, pasi ka pasur abuzime shumë të mëdha. Nga ana e flotave tona nuk është vënë re abuzim i tillë, por abuzime shumë të mëdha janë vënë re nga organizatat ndërkombëtare që monitorojnë detet. Shumë anije kanë arritur të derdhin edhe ndotje toksike në ilegalitet, kështu që janë rritur shumë masat shtrënguese në këtë sens.

Kërkesa të reja të trajnimit dhe certifikimit për oficerët elektroteknikë.

Përditësimi i kërkesave të kompetencës për personelin që shërben në të gjitha llojet e cisternave, duke përfshirë kërkesat e reja për personelin që shërben në cisternat me gaz të lëngët, por në përgjithësi edhe cisternat që kanë lëndë shpërthyes.

Kërkesa të reja për trajnimin e sigurisë, si dhe dispozita për të siguruar se detarët janë të trajnuar siç duhet për të përballuar nëse anija e tyre bie pre e sulmit të piratëve. Edhe këtu merren disa masa paraprake dhe kërkohet një trajnim specifik. Sidomos janë disa zona të deteve, të cilat janë konsiderohen zona risku. Përgjithësisht ne i kemi evituar, por kjo nuk presupozon që të mos ketë edhe sulme në zona që konsiderohen relativisht të sigurt.

Futja e teknologjisë së trajnimit modern duke përfshirë mësimin në distancë dhe trajnimin në internet.

Udhëzime të reja trajnimi për personelin që vepron në sistemin pozicionues dinamik.

Këto janë pak a shumë pikat kryesore që doja të thosha, pa u futur në detajet teknike të projektligjit që të gjithë e kanë përpara. Nëse dikush kërkon specifikime më të hollësishme,

ne mund t'ua japim këtë material edhe në formë elektronike. Kodi është shumë i gjerë dhe kryesisht në këtë material më së shumti ka tabela.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shkreli!

Fjalën e ka relatori i projektligjit, zoti Leka.

Edmond Leka - Faleminderit, kryetar!

Miratimi i këtij projektligji bëhet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare IMO-s, “Për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-s për plotësimin e standardeve ndërkombëtare të detarisë”. Miratimi i këtij akti do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të nevojshme për trajnimin dhe kualifikimin e marinarëve të sotëm duke u bazuar në standardet ndërkombëtare. Dispozitat e këtij akti do të jenë të detyrueshme jo vetëm për detarët, por edhe për pronarët e anijeve, institucionet e trajnimit dhe administratat kombëtare detare.

Për sa u përket ndryshimeve dhe përmirësimeve që ky aderim na ofron, zoti Shkreli ishte shterues për teknologjitë dhe metodologjitë e reja që do të na ofrohen për detajet dhe kriteret e orëve të punës të marinarëve. Unë mendoj që në aspektin ligjor dhe procedural është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, prandaj ju ftoj ta miratojmë dhe kalojmë në seancë plenare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Bushka. Më pas e ka fjalën zoti Fino.

Klotilda Bushka – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit për prezantimin!

Shikoj që në parashikimet e këtij akti bëhet fjalë për rishikimin e kërkesave për orët e punës dhe të pushimit, si dhe kërkesa të tjera që kanë të bëjnë me çështje që rregullohen nga Kodi Detar. A është ky akt i vetëzbatueshëm direkt apo kemi nevojë për ndryshime ligjore? Në fakt, kemi dy ligje, siç është Kodi i Punës dhe Kodi Detar, të cilët miratohen me shumicë të cilësuar. Pra, nëse e miratojmë këtë akt që po propozoni, krijohet konflikt me Kodin Punës dhe Kodin Detar, që do të duhet të na çojë përpara një situatë për të bërë rishikim të këtij legjislacioni, pra, për të përmbushur në mënyrë eficiente detyrimet tona.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Faleminderit!

Kjo nuk bie ndesh me dy dispozitat që përmendët ju, kodin dhe ligjin. Është parashikuar që këto diferenca janë brenda këtij kuadri. Është praktikë në përputhje me dispozitat e Konventës së Punës së Detit, të ILO-s, të vitit 2006, që është ratifikuar në vitin 2015 nga Republika e Shqipërisë. Nuk kemi ndryshim dhe nuk lind nevoja për një ndryshim në kod, që natyrisht do të ishte shumë problematike. Kanë qenë edhe përpara të zbatueshme, por edhe këto rregullime janë në të njëjtën linjë.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Shkreli, për shpjegimet, për kulturë më tepër, sepse ky është një ratifikim rutinë që bëjmë ne si parlament!

Kur lexova relacionin dhe pashë gjithë këto rezoluta, rreth 19 të tilla, që kanë ndryshuar dhe që ndryshojnë realisht në materialin prej 400 faqesh për aderimin në aktin final të konventës ndërkombëtare për standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit detar, vura re që kjo konventë është realizuar në vitin '78 dhe ka bërë ndryshime në Manila në vitin 2010. Ne po shkojmë drejt vitit 2020 dhe ne po ratifikojmë pas 10 vjetëve ndryshimet që ata kanë paraqitur në këtë konventë. Më duket pak kohë e gjatë. A keni ndonjë përgjigje për këtë?

Së dyti, ajo që më intrigon më shumë, për kulturë më tepër (zoti Leka mbase e di, sepse është nga Vlora), çdo të thotë “viti i detarëve” dhe “dita e detarëve”? Janë dy rezoluta që pasqyrohen këtu, ne do t'i votojmë, aderojmë, e të tjera?

Ulsi Manja – Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Për sa i përket pyetjes së parë të deputetit Fino, duhet të themi që në përgjithësi ka pasur vonesa, por vonesa nuk është shumë e madhe për motivin që STCW është krijuar në vitin '95, ratifikimi dhe ndryshimet e Manilës janë bërë në vitin 2010, por ndërkohë, shtete të ndryshme kanë pasur përshtatjet e tyre me legjislacionet në varësi në shpejtësisë me të cilën kanë operuar.

Pyetja që bëri pak më parë deputetja kishte të bënte nëse binte ndesh çështja e orëve të punës me Kodin Detar, të cilat ndonjëherë marrin dhe disa vite kur nuk bëhen numrat.

Edhe në qoftë se korpusi i përgjithshëm është miratuar, ne aderojmë përsëri në ndryshimet e Manilës. Pra, kjo nuk na ka lënë jashtë. Kjo është për t'u azhurnuar dhe bërë pjesë

...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, jemi 97% të aderuar, kurse sot me këto amendime adero kemi 100%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam dijeni se çfarë është “viti i detarëve” (më falni për injorancën), por me siguri do të jetë ndonjë rezolutë në të cilën ata pranojnë, që sikurse ka një ditë ndërkombëtare për librin apo një ditë ndërkombëtare për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, ju kërkoj ndjesë! Sapo të kthehem në zyrë do t’jua nis ...

“Ditën e detarëve” e kam shumë të qartë, kurse “vitin e detarëve” nuk e di.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shkreli!

Ka pyetje nga kolegët e tjerë? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

E hedhim në votim në parim?

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1

Pro? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2

Pro? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, e vitit 1978”.

Zoti Shkreli, faleminderit për prezencën në komision dhe ditë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – Patjetër që do t’jua nis shpjegimin se çfarë është “viti i detarëve”. Dita e detarëve është 25 qersori. Kam idenë që ata një herë në dhjetë vjet caktojnë një vit që konsiderohet se ka aktivitet ...

Ulsi Manja – Gjithsesi, zoti Shkreli, përpara se relatori dhe këshilltarët të bëjnë raportin për komisionin përgjegjës, mund t’i sillni edhe ato çfarë kërkoi kolegu Fino.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Artan Shkreli – Rrofsh!

Ulsi Manja – Të nderuar kolegë, për shkak të një defekti që patën në fillim në sistemin audio, jam i detyruar që pikën 1 dhe pikën 2 të rendit të ditës t’i hedh edhe një herë në votim, sepse nuk ka regjistruar sistemi audio, pavarësisht se ne i miratuam.

Pika e parë është miratimi i draftkalendarit të punës së komisionit për periudhën 25 nëntor – 20 dhjetor 2019.

Pro? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika e dytë është miratimi i draftkalendarit të komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020.”

Pro? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pikën e tretë për shqyrtimin e projektligjit sapo e miratuam.

Me këtë votim e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë kolegëve dhe mediave për pasqyrimin e kësaj seance!

MBYLLET MBLEDHJA